



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100212/22

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e një vakti ushqim dhe ujë të pijshëm për të burgosurit gjatë shoqërimit të tyre me automjet, nëse distanca është e largët dhe pritja është e gjatë si dhe për stafin (punonjësit) e shoqërimit.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Drejtorit të Përgjithshëm

Z. Agim Ismaili

Tiranë

I nderuar Z. Ismaili,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i dënuari O. X., i cili ndër të tjera, ka shprehur shqetësimin lidhur me trajtimin e tij gjatë shoqërimit me automjetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga IEVP "Jordan Misja", Tiranë për në IEVP Fier. Më konkretisht, i dënuari shpjegon se vuan dënimin në IEVP Fier dhe qëndron herë pas here tranzit në IEVP "Jordan Misja", Tiranë për të marrë pjesë në seancat gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në mëngjesin e datës 06.05.2021, pas qëndrimit tranzit në IEVP "Jordan Misja", ai është marrë në dorëzim nga punonjës të policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për t'u kthyer në IEVP Fier. Sipas ankuesit, para se të mbërrijë në IEVP Fier, automjeti ka ndaluar në Durrës e Kavajë, ku janë marrë dy të burgosur të tjerë e në vijim ata kanë udhëtuar për në Vlorë, ku i dënuari

O. X. ka pritur të përfundojë seanca gjyqësore për një nga të burgosurit bashkëudhëtarë. Gjatë udhëtimit ai u ka kërkuar ujë për të pirë punonjësve të policisë të burgjeve që e shoqëronin, por i është dhënë për të konsumuar vetëm patatina të blerë nga këta punonjës me shpenzimet e tyre.

Për të verifikuar ankesën e të dënuarit O. X. kemi patur letërkëmbim me I EVP “Jordan Misja” dhe I EVP Fier për t’u informuar lidhur me kohëzgjatjen e udhëtimit të tij në datën 06.05.2021. Gjithashtu, u interesuam për faktin nëse të burgosurve u jepet ushqim dhe ujë për t’i konsumuar gjatë shoqërimit jashtë I EVP-së. Për më tepër, kemi analizuar edhe rregullat e parashikuara ligjorë që zbatohen kur i burgosuri shoqërohet me automjet jashtë I EVP-së, për arsye të pjesëmarrjes në proceset gjyqësore, vizita mjekësore dhe qëllime të tjera.

Referuar përgjigjes¹ së marrë në lidhje me rastin në hetim nga I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, i dënuari O. X. ka dalë prej këtij institucioni në datën 06.05.2021, në orën 07:15, për t’u kthyer në I EVP Fier. Për sa i përket trajtimit me ushqim të të burgosurve gjatë shoqërimit, kjo I EVP shprehet se atyre nuk u jepet ushqim në kthim pas qëndrimit tranzit, me arsyetimin se ata do të marrin trajtim ushqimor në I EVP-në ku vuajnë dënimin.

Ndërsa, referuar përgjigjes² së marrë nga I EVP Fier, nga verifikimi i librit të regjistrimit të hyrje-daljeve të të burgosurve në institucion rezulton se i dënuari O. X. është sjellë nga ana e automjetit të shoqërimit të Forcave Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në datën 06.05.2021, në orën 12:50. Sa i përket interesimit tonë nëse i jepet gjatë shoqërimit jashtë institucionit të burgosurit ushqim me vete për ta konsumuar gjatë udhëtimit, I EVP-ja na është përgjigjur se nuk i jepet me vete ushqim të burgosurve që ta konsumojnë gjatë udhëtimit, për arsye se në zbatim të rregullave të sigurisë ata duhet të prangosen me duar prapa shpine dhe automjeti mund të ndalojë gjatë rrugës vetëm për shkaqe të përlijtura.

Duke përlloritur të dhënat e orarit të shoqërimit jashtë institucioneve, sipas informacioneve të sipërpërmendura, rezulton se kthimi i të dënuarit O. X. nga I EVP

¹ Shkresa me Nr.1956 Prot., datë 28.05.2021.

² Shkresa Nr.2136/1 prot., protokolluar pranë institucionit tonë në datë 27.05.2021.

“Jordan Misja”, Tiranë për në IEVP Fier ka qenë me një kohëzgjatje 5 orë e 30 minuta dhe atij nuk i është dhënë ushqim e ujë i pijshëm me vete nga IEVP “Jordan Misja” për t’u konsumuar gjatë udhëtimit për arsyet e cituara më lart.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë edhe më parë në shqyrtim ankesa që kanë të bëjnë me trajtimin e të burgosurit gjatë shoqërimit me automjet. Për të verifikuar ankesën e një të dënuari, i cili pretendonte se kishte qëndruar rreth 12 orë pa u ushqyer³ në automjetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, gjatë hetimit tone administrativ kemi kërkuar të informohemi⁴ nëse ishte parashikuar fond i veçantë shpenzimesh për t’u siguruar ushqim të burgosurve kur ata shoqërohen nga IEVP-ja për në gjykatë e pas mbarimit të seancës gjyqësore nga organi i gjykatës për në IEVP. Po ashtu kemi kërkuar nëse lejohen të burgosurit të marrin me vete ushqime gjatë shoqërimit. Në përgjigjen⁵ që kemi marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve thuhet se:

“Në lidhje me trajtimin ushqimor të të burgosurve që shoqërohen për në IEVP apo në gjykata, DPBurgjeve nuk ka të parashikuar një fond të veçantë për ushqimin e tyre kur ata shoqërohen pasi këta janë të përfshirë në normën ditore të ushqimit të IEVP ku vuajnë dënimin.

Për sa i përket organizimit të shoqërimit të tyre apo dhe sendeve personale që mund të marrin të burgosurit me vete gjatë shoqërimit, kjo e fundit është përcaktuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Nr.7686, datë 03.10.2018 “Për mënyrën e organizimit të shërbimeve të policisë, për shoqërimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në seanca gjyqësore” si dhe Urdhrit Nr.9157, datë 21.09.2018 “Mbi qëndrimin tranzit (qëndrim i përkohshëm) i të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP”.

Gjithashtu, për rastin e hetuar më parë (ankesa e të dënuarit E.M) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na ka vënë në dispozicion dokumentacionin ku përcaktohen rregulla të hollësishme lidhur me shoqërimin e të burgosurve. Këto dokumente janë si vijon:

- Rregullore e hollësishme e sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve miratuar me Urdhër Nr.5251/1, datë 30.07.2010, të Ministrit të Drejtësisë;

³ Nga komunikimi shkresor, evidentojmë faktin se është pranuar nga Forca Operacionale e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve se në ditën që referon i dënuari E.M, automjeti ka ndaluar në disa qytete.

⁴ Shkresa Nr.K2/E33-32 Prot., datë 03.10.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

⁵ Shkresa Nr.9730/1 Prot., datë 16.10.2018.

- Urdhri Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Transportimi dhe shoqërimi i të Burgosurve”;
- Udhëzues Administrativ në Sistemin e Burgjeve Shqiptare, Tiranë 2013, i punuar bashkërisht me Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

Një nga këto akte, që vlerësohet me rëndësi në analizën tonë, është Urdhri Nr.651, datë 21.01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Transportimi dhe shoqërimi i të Burgosurve”, nëpërmjet të cilit është miratuar procedura për marrjen e masave të sigurisë nga ana e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve, gjatë shoqërimit jashtë perimetrit të sigurisë, për arsye të pjesëmarrjes në proceset gjyqësore, vizita mjekësore dhe qëllime të tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, duke garantuar të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve dhe sigurinë publike. Duke iu referuar Kreut II të Urdhrit Nr.651, datë 21.01.2019, konstatojmë se në të i kushtohet rëndësi përgatitjes dhe planifikimit të udhëtimit si një hap i parë madhor që duhet kryer. Në pikën 2.2.2 të këtij kreu përcaktohet se duhet të sigurohet një vakt ushqim për punonjësit (stafin e shoqërimit) si dhe për të dënuarit, nëse janë distanca të gjata.

Ndërsa në Kreun III të këtij urdhri “Detyrat e Përgjegjësit të Grupit të Shoqërimit”, në pikën 3.3 “Veprimet dhe përgjegjësitë gjatë udhëtimit” përcaktohet:

Mbani parasysh gjatë lëvizjes:

- *Nëse një i burgosur dhe një polic bëhet sëmurë ose kërkohet të përdoret tualeti para se të arrihet në destinacion, gjendet komisariati ose burgu më i afërt dhe lajmërohet reparti ose sektori.*
-
- *Masat për vaktet dhe ndalesat për nevoja personale do të merren në bashkëpunim me institucionet e tjera penale ose forcat policore (teksta transportojnë të burgosur automjetet e shoqërimit nuk duhet të ndalojnë pa qenë nevoja)”.*

Po kështu, në kreun IX “Transporti i të burgosurit”, të Udhëzuesit Administrativ të cituar më lart, si pjesë e procedurës së transportit, në pikën 7, parashikohet:

Pika 7

- *“T’i sigurohet një vakt ushqimor dhe ujë i pijshëm të burgosurit, nëse distanca është e largët dhe pritja është e gjatë;*
 - *Vakti ushqimor apo uji i pijshëm nuk pakëtohen në enë xhami ose metalike”.*

Çmujmë se sigurimi i ushqimit për të burgosurit dhe stafin shoqërues në të tilla raste jo vetëm është detyrim që buron nga rregullat dhe aktet e sipërpërmendura, por është edhe trajtim njerëzor i të burgosurve, të cilët qëndrojnë për një kohë të gjatë në kushtet e automjetit (veçanërisht kur kemi të bëjmë me të burgosur të mitur, femra dhe ata me probleme shëndetësore që kanë nevoja të veçanta), është trajtim në përshtatje me detyrën që po kryejnë punonjësit e burgjeve, të cilët gjithashtu kalojnë kohë të gjatë në automjet, në kushte dhe stres të shtuar. Nga ana tjetër kemi të mendimit që ndryshimet pozitive që ka pësuar kuadri ligjor penitenciar, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe rekomandimet e CPT-së, sjellin si nevojë përmirësimin dhe parashikimin e rregullave dhe procedurave më të qarta në këtë drejtim për të garantuar respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore si dhe trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim.

Në vlerësimin tonë, mundësia e të burgosurit për të konsumuar ushqimin dhe për të pirë ujë krijohet edhe pa cënuar masat e sigurisë. Nëse një i burgosur do të shoqërohet nga një vend në tjetrin dhe është planifikuar që automjeti të bëjë ndalesa gjatë rrugës në IEVP apo gjykatë, në këto ndalesa automjeti do të gjendet brenda një perimetri sigurie dhe aty, në pritje, të burgosurit i lidhen duart me pranga përpara për të konsumuar ushqimin. Nëse automjeti do të transportojë të burgosur pa ndalesa, në një distancë të gjatë, mund të ndalojë për disa minuta në një IEVP apo komisariat gjatë rrugës, ku të shihet më e përshtatshme duke koordinuar veprimet dhe bashkëpunuar me institucionet e tjera penale apo forcat policore, dhe aty i burgosuri në kushte sigurie konsumon vaktin dhe mund të kryejë nevojat personale. Ushqimi që do të konsumojë stafi edhe të burgosurit përgatitet në formën e sanduiçit (ushqim i shpejtë) dhe uji i pijshëm duhet të jetë i paketuar me shishe plastike, në mënyrë që të konsumohet shpejtë dhe pa cënuar elementët e sigurisë. Mendojmë se kjo është një praktikë e mirë, duke patur parasysh edhe përvojën që kemi fituar nga pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta të riatdhesimit të detyruar të shtetasve shqiptarë që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Këto operacione janë organizuar në mënyrë të ndërsjelltë nga Franca, Belgjika, Shqipëria

dhe FRONTEX (policia e përbashkët e shteteve anëtare të BE që ndihmon në mbikëqyrjen e kufijve me vendet jo anëtare). Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit marrin pjesë në këto operacione, si mbikëqyrës të jashtëm të pavarur, të cilët kanë për detyrë mbledhjen e informacionit nëse respektohen të drejtat themelore të njeriut, të shtetasve shqiptarë që riatdhesohen. Një nga pikat të cilës i jepet rëndësi, është edhe ajo e ushqimit të të riatdhesuarve gjatë transportit ajror me avionë të posaçëm për në Shqipëri.

Në përfundim të hetimit tonë administrativ të ankesës së paraqitur nga i dënuari O. X., jemi të mendimit se përmirësimi i trajtimit të të burgosurve gjatë transportit me automjet por edhe i parashikimit të rregullave dhe procedurave më të qarta në këtë drejtim si dhe trajnimi i punonjësve pjesë e grupeve të shoqërimit, do të përmbushte më mirë qëllimin e Ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, që sipas nenit 2 është garantimi i kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimi i të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimi i sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e një vakti ushqim dhe ujë të pijshëm për të burgosurit gjatë shoqërimit të tyre me automjet, nëse distanca është e largët dhe pritja është e gjatë si dhe për punonjësit (stafin) e shoqërimit.
- Marrjen e masave të nevojshme për parashikimin e rregullave dhe procedurave më të qarta për sigurimin e një vakti ushqim dhe ujë të pijshëm për të

burgosurit gjatë shoqërimit të tyre me automjet, nëse distanca është e largët dhe pritja është e gjatë, në funksion të përmirësimit të trajtimit të tyre.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi